

VENDIM
Nr. 223, datë 23.10.2024

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 132, DATË 2.7.2024, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENNAT SOLAR PARK BALLSH” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 979/18 prot., datë 21.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘GreeNNat Solar Park Ballsh’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 132, datë 2.7.2024, vendosi të licencojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 11.1.2028.

- Shoqëria “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 979/17 prot., datë 19.9.2024, paraqiti kërkesën për modifikimin e datës së hyrjes në fuqi të licencës së dhënë me vendimin e sipërcituar, duke përcaktuar si datë fillimi datën 20.10.2024, pasi ndërtimi i veprës është i ndarë në dy lote: loti 1–25 mw, 6/35 kV; loti 2 – 75 mw, dhe programi i punës parashikon që loti 1–25 mw 6/35 kw do të komisionohet në këtë datë. Po ashtu, shoqëria informon se në referencë të nenit 10 të kontratës nr. 31 rep., nr. 13/5 kol., datë 27.1.2023, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) ka marrë masat e nevojshme për të kryer testimin e veprës.

- Rezulton se shoqëria disponon miratimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. për lidhjen e centralit fotovoltaiik të shoqërisë me fuqi 100 mwp me rrjetin e transmetimit, si dhe miratimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes të burimit të ri gjenerues të energjisë fotovoltaike me fuqi të instaluar 25 mw.

- Pra, për sa kërkohet nga ana e shoqërisë për të ndryshuar datën e fillimit të operimit për një pjesë të kapacitetit të instaluar të centralit (atë 25 mw), duke marrë në konsideratë faktin se ajo ka miratimin përkatës nga operatori i rrjetit të shpërndarjes që përkon me këtë kapacitet, vlerësohet se kjo kërkesë është e justifikuar nga ana e saj, ndaj afati i fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së licencuar për këtë kapacitet do të jetë data e hyrjes në fuqi të vendimit të Bordit ku reflektohet ky ndryshim.

- Nga ana tjetër, fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së licencuar për kapacitetin e mbetur prej 75 mw (i cili do të ndërtohet në fazën e dytë sipas parashikimeve), me hyrjen në operim të të cilit plotësohet kapaciteti i plotë i centralit për të cilin është licencuar shoqëria, duhet të bëhet jo më vonë se data 11.1.2028, afat i cili i referohet përcaktimeve të VKM-së nr. 6/2023 dhe kontratës me MIE-n nr. 31 rep., nr. 13/5 kol., datë 27.1.2023, për vënien në operim të të gjithë centralit gjenerues të energjisë elektrike. Me vënien në operim të centralit për kapacitetin e plotë, sipas pikës së lidhjes me OST (e miratuar për 100 mwp) do të shfuqizohet përcaktimi në lidhje me hyrjen në operim të kapaciteti prej 25 mw.

- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e ndryshimit të një akti, me nismën e vetë organit që e ka

nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 132, datë 2.7.2024, ndryshon si vijon:

1. Të licencojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 100 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5, me përmbajtje si vijon:

3. Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike për kapacitetin e instaluar prej 25 mw me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve.

4. Shoqëria të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së licencuar për kapacitetin e plotë prej 100 mw jo më vonë se data 11.1.2028.

5. Me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së licencuar, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij vendimi, pika 3 shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “GreeNNat Solar Park Ballsh” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti